



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 dhjetor 2021
Nr. ref.: RK 1912/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI155/21

Parashtrues

Deli Shatri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev.nr. 485/2020, të 17 qershorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Deli Shatri me vendbanim në Llaushë, Komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev.nr. 485/2020] të 17 qershorit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
6. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci.
7. Më 7 shtator 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoj sqarim nga i njëjti që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, ta njoftonte Gjykatën lidhur me shkeljet e pretenduara përmes Vendimit të kontestuar.
8. Më 29 tetor 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
9. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rezulton që shtëpia e parashtruesit të kërkesës ishte djegur më 14 janar 2010. I njëjti pretendonte se kjo u shkaktua nga defekti i energjisë elektrike, rrjedhimisht ushtron padi kundër KEK-ut (Korporatën

Energjetike të Kosovës) për kompensim të dëmit material të pësuar, dhe atë shumë prej 8.905 euro (për orenditë shtëpiake të djegura), si dhe 14.379 euro (për renovimin e shtëpisë), në total 23.284 euro me kamatë duke filluar nga 23 tetori 2010. Ndaj kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, e padituria-KEK dorëzoi përgjigje në padi duke theksuar se i njëjti nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga zjarri i shpërthyer brenda shtëpisë së parashtruesit të kërkesës.

11. Më 9 nëntor 2011, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C.nr.45/2010]: (i) aprovoi pjesërisht si të bazuar padinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi KEK-un që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë dëmin material të pësuar në shtëpinë e tij, nga shpërthimi i zjarrit prej energjisë elektrike, në shumë prej 14,379.44 €, dhe shumë prej 533,00 € për orenditë dhe gjësendet e djegura në shtëpi, gjithsej në shumë prej 14.912.44 € me kamatën ligjore si për mjete të afatizuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar nga dita e gjykimit [...]; (iii) refuzoi si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë në shumë prej 8.372,00 € në emrin e orendive dhe gjësendeve të djegura.
12. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, ankesë dorëzuan në Gjykatën e Apelit: (i) parashtruesi i kërkesës në cilësinë e paditësit dhe (ii) KEK-u në cilësinë e të paditurës.
13. Më 9 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 1944/2017] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të paditurës - KEK, ndërsa vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [C.nr.45/2010] e Gjykatës Themelore, të 9 nëntorit 2016.
14. Në një datë të pacaktuar, KEK-u paraqiti kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës se Apelit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme, të aprovojë revizionin e paraqitur, ashtu që të ndryshojë aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, dhe ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti përgjigje në revizion.
15. Më 17 qershor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.485/2020] e pranoi si të bazuar revizionin e të paditurës-KEK, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, ashtu që e refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kishte kërkuar të detyrohet e paditura KEK-u që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë dëmin material që e ka pësuar në shtëpinë e tij, më 14 janar 2010, nga shpërthimi i zjarrit prej energjisë elektrike, në shumë prej 14,379.44 euro, dhe shumë prej 533,00 euro për orenditë dhe gjësendet e djegura në shtëpi, gjithsej në shumë prej 14.912.44€ me kamatën ligjore si për mjete të afatizuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar nga dita e gjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2179.00€.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
17. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se përmes Aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë në tërësi ishte vërtetuar gjendja faktike, janë tri ekspertiza të bëra, ndërsa Gjykata Supreme, duke marrë rastin në duar të veta dhe pa bërë ndonjë ekspertizë tjetër refuzon padinë nga fakti se gjykata në ekspertizën e ekspertit R. S. nuk ka nxjerrë ndonjë përfundim dhe nuk kishte qasje analitike. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme kishte marrë rolin e ekspertit duke mohuar ekspertizën e grupit të ekspertëve.
18. Parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Qëllimi im është se kjo gjykatë të vërtetoi se më janë shkel të drejtat mija lidhur me mbrojtjen e të drejtë së pronës neni 46, dhe ajo e Gjykimit të paanshëm pranë Gjykatave neni 31 në lidhje me këtë rast dhe konsideroi se në rast se për vërtetimin e gjendjes faktike duhet nxjerr edhe ndonjë provë gjykata nuk ka mund sipas ligjit të merr rolin e ekspertit, por është dashtë që të PRISHEN Aktgjykimet, ai i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë dhe lënda ti KTHEHET Gjykatës së shkallës së parë në RIVENDOSJE me sugjerim që kjo Gjykatë të nxjerr këtë provë, përmes ekspertëve sepse dihet cila lami e eksperteve e bënë ekspertizën ANALITIKE”.*
19. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të prishet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe lënda të rikthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e

të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 46 **[Mbrojtja e Pronës]**

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
- 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
22. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 **(Kërkesa individuale)**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”
[...]*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

23. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
24. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

25. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KI04/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
26. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose

vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*" (shih më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*", Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284 shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

27. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
28. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjell në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Pra, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar padi kundër KEK-ut si rezultat i djegies së shtëpisë, me ç' rast kërkonte kompensim të dëmit material të pësuar. Gjykata Themelore kishte aprovuar pjesërisht kërkesën e tij. Ankesat respektive të parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur –KEK, i refuzoi si të pabazuara Gjykata e Apelit, duke vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Përfundimisht, Gjykata Supreme e aprovoi kërkesën për revizion të palës së paditur-KEK, ashtu që e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, ashtu që e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka vendosur duke marrë rolin e ekspertit, prandaj kërkon nga Gjykata që të prishet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe lënda të rikthehet në rivendosje.
29. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij të garantuara me: (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm]; dhe (ii) me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, ku ai kryesisht thekson se Gjykata Supreme ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë veç e veç pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës

30. Gjykata sjell në vëmendje se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në ndërlidhje me të drejtën e pronës.
31. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm, përbëjnë kategori pretendimesh, të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, në parim, i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*".
32. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 1 gushtit 2021, për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. "Shkalla e katërt", paragrafët 287 deri në 294), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgijzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
33. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, para 58).
34. Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyetoi në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të cilave dispozita materiale ka nxjerrë aktgjykimin përkatës, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës

vendosi Gjykata Supreme, e cila e aprovoi revizionin e ushtruar nga e paditura, përkatësisht KEK-u, e cila arsyetoi si në vijim:

“Gjykata Supreme pretendimet si ne revizion te ushtruar nga e paditura, nga arsyet e larte cekura, i konsideron si të themelta, pasi që për dëmin e shkaktuar nuk është vërtetuar përgjegjësia e palës së paditur, andaj edhe gabimisht janë aplikuar dispozitat e nenit 173, nenit 174 paragrafi 1, dhe nenit 177 të LMD, Gz. 29/78, si dhe dispozitave të nenit 13 paragrafi 1 pika a), nenit 18 paragrafi 18.1 pika a), nenit 29 paragrafi 1 dhe nenit 30 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 2004/10, pasi nga provat e administruara nuk është vërtetuar se zjarri është shkaktuar si rezultat i luhatjes së tensionit, apo për shkak të prishjes në rrjetin e furnizimit nën përgjegjësinë e të paditurës. andaj

edhe nuk ka bazë që të vendoset sipas nenit 173 të LMD-së, të përgjegjësisë së të paditurës për sendin e rrezikshëm, pasi në rastin konkret nuk është vërtetuar se zjarri ka ardhur si rezultat i mos mirëmbajtjes së rrjetit - lëshimeve të paditurës, ndërsa përdorimi i energjisë elektrike në kushtet normale dhe sipas rregullave të përdorimit, deri sa nuk ka çrregullime të furnizimit me energji elektrike, nuk paraqet send të rrezikshëm.

Me dispozitën e nenit 154 par. 1, të LMD-së, ligjvënësi ka përcaktuar bazat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, ka përcaktuar obligimin e secilit që të përgjigjet për dëmin që e shkakton që do të thotë se fajësia për dëmin supozohet për dëmtuesin, dhe duhet të vërtetohet e kundërta. Përndryshe nuk mund të lirohet nga përgjegjësia, sipas kësaj dispozite barra e të provuarit se kush e ka shkaktuar dëmin, dhe kjo i takon atij që pretendon se i është shkaktuar dëmi, ndërsa personi përgjegjës për dëmin e ka barrën e të provuarit se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, andaj në rastin konkret e paditura me provat e prezantuara dhe administruara ka vërtetuar faktin se dëmi nuk ka ardhur si rezultat i lëshimeve apo mos veprimit të ndërmarrjes së masave nga e paditura – (KEK, theksim i shtuar).”

35. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtuesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtues *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, të cituar më lart, paragrafi 58).
36. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të ligjit, për shkak se

gjykatat e rregullta kanë zbatuar rregullin “në dëm të këtij parashtruesi të kërkesës”, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (shih rastin e Gjykatës KI64/20, parashtrues: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

37. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkëljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar dhe aplikimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm, paraqesin pretendime (i) që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
39. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të parapara me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së vendosur gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë “të pambështetura apo të paarsyetuara” dhe kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës* (Vendim) nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës* (Vendim) nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
- b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vetë nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e*

40. Në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës pretendon se i “*janë shkel të drejtat ... lidhur me mbrojtjen e të drejtës së pronës neni 46,*”, por i njëjti nuk shpjegon në mënyrë specifike se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi në nene të Kushtetutës dhe të KEDNj-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, parashtues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 i cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, parashtues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
41. Prandaj, Gjykata konkludon që sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyeshme*”, sepse parashtuesi i kërkesës thjesht ka përmendur një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato ishin shkelur. Rrjedhimisht, këto pretendime të parashtuesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

42. Në fund, Gjykata konkludon që kërkesa e parashtuesit të kërkesës është e papranueshme, sepse: (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës që ndërlidhen me pohimet e parashtuesit të kërkesës se ka pasur interpretim të gabuar dhe aplikim të gabuar të ligjit të zbatueshëm, janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtuesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; si dhe (ii) pretendimet përkitazi me pohimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyeshme*”. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani